

VENDIM
Nr.494, datë 15.5.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË PESË AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe dërgimin e forcave ushtarake shqiptare, jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, më 18 maj 2009, në itinerarin Qafë-Thanë – porti i Durrësit, të dy autokolonave ushtarake italiane, si më poshtë vijon;
 - Autokolona e parë përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa;
 - Autokolona e dytë përbëhet nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa.
2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, më 20 maj 2009, në itinerarin porti i Durrësit – Qafë-Thanë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 28 (njëzet e tetë) trupa.
3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, më 22 maj 2009, në itinerarin porti i Durrësit – Qafë-Thanë, të dy autokolonave ushtarake italiane, si më poshtë vijon:
 - Autokolona e parë përbëhet nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa;
 - Autokolona e dytë përbëhet nga 1 (një) automjet dhe 2 (dy) trupa.
4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë më 18 maj 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar në portin e Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë më 20 e 22 maj 2009, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.
5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha